# FLETË E STANDARTIZUAR E INFORMACIONIT PARAKONTRAKTOR KREDI HIPOTEKORE PËR INDIVIDË

| Zërat | Përshkrimi |
|---|---|
| **Teksti prezantues** | Ky dokument nuk përbën një ofertë ligjore detyruese. Shifrat janë dhënë në mirëbesim dhe janë një prezantim i saktë i ofertës që banka do të bëjë sipas kushteve aktuale të tregut, bazuar në informacionin e dhënë. Megjithëkëtë, këto shifra mund të luhaten sipas kushteve të tregut. Dhënia e këtij informacioni nuk përbën detyrimin e kësaj të fundit për të akorduar kredi. |
| **1. Banka** | BANKA KOMBETARE TREGTARE (BKT) SH.A<br>Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Tirane<br>Adresa e web-it: www.bkt.com.al<br>Email: info@bkt.com.al<br>Numri i telefonit: 042 266 288 |
| **2. Qëllimi i produktit** | Nëpërmjet kredive hipotekore synohet të përmbushen nevojat personale të individëve për blerje, ndërtim ose rindërtim shtëpie, por edhe të personave profesionistë të vetpunësuar (mjek, dentist, farmacist, avokat etj) të cilët duan të blejnë ose ndërtojnë ambjentet e tyre të punës. |
| **3. Përshkrimi i produktit** | Ky produkt përdoret për qëllimin e parashikuar në pikën 2 ku si garanci banka do të kërkojë hipotekë të pasurive të paluajtshme.<br>Sende të hipotekueshme janë pasuritë e paluajtshme, si toka, ndërtesat dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën. Prona e hipotekueshme mund të jetë e ndryshme nga objekti i kredisë.<br>Raporti i vlerësimit të pasurive të paluajtshme kryhet nga vlerësues të pavarur të autorizuar nga banka dhe kjo kosto mbulohet nga aplikanti. Në çdo rast vlera imediate e likuidimit të pasurisë do të jetë minimumi 120% e vlerës së kredisë së akorduar ose vlera e tregut te lire per pronen do të jetë minimumi 150% e vlerës së kredisë së akorduar. Për tokat bujqësore vlera imediate e likuidimit të pasurisë do të jetë minimumi 160% e vlerës së kredisë së akorduar.<br>Shlyerja e kredisë do të kryhet me këste të barabarta mujore (kryegjë + interes) sipas aneksit të shlyerjes dhe jo si shlyrje e njëhershme në fund të afatit të maturimit. Banka financon deri në 80% të vlerës së pasurisë (bazuar tek kontrata e shitjes), ndërkohë që aplikanti duhet të paguajë të paktën 20 % të vlerës së pasurisë në formë kapari. Sa më i lartë të jetë kapari aq më i vogël do të jetë kësti mujor i paguar nga aplikanti. |
| **4. Norma e interesit për Kredi për shtëpi / Kredi për Ndërtim Shtëpie**<br><br>**(tregon llojin e interesit dhe kohëzgjatjen e periudhës së përcaktuar, monedha Lekë/Euro)** | **Monedha LEKË**<br><br>***<u>Kliente Preferenciale</u>*:**<br>3.5% për 24 muajt e pare, më pas Bono Thesari + 1.4%<br>***(jo me pak se 3.6% pas 24 muajve te para e ndryshueshme çdo 12 muaj)***<br>*Ose:*<br>Bono Thesari 1 vjeçare +1.3% *(e ndryshueshme çdo 12 muaj)*<br>***(jo me pak se 3.6% pas 24 muajve te pare)***<br><br>***<u>Kliente Pagamarres ne BKT</u>*:**<br>3.5% për 24 muajt e pare, më pas Bono Thesari + 1.6%<br>***(jo me pak se 3.8% pas 24 muajve te para e ndryshueshme çdo 12 muaj)***<br>*Ose:* |

| | |
|---|---|
| | Bono Thesari 1 vjeçare + 1.5% *(e ndryshueshme çdo 12 muaj)*<br>***(jo me pak se 3.8% pas 24 muajve te pare)***<br><br>***Klientë Pagamarrës në çdo bankë:***<br>3.5% për 24 muajt e pare, më pas Bono Thesari + 1.9%<br>***(jo me pak se 4% pas 24 muajve te para e ndryshueshme çdo 12 muaj)***<br><br>*Ose:*<br>Bono Thesari 1 vjeçare + 1.7% *(e ndryshueshme çdo 12 muaj)*<br>***(jo me pak se 4% pas 24 muajve te pare)***<br><br>***Kliente individuale standart*:**<br>3.5% për 24 muajt e pare, më pas Bono Thesari + 2.5%<br>***(jo me pak se 4.5% pas 24 muajve te para e ndryshueshme çdo 12 muaj)***<br><br>*Ose:*<br>Bono Thesari 1 vjeçare + 2.2% *(e ndryshueshme çdo 12 muaj)*<br>***(jo me pak se 4.5% pas 24 muajve te pare)***<br><br>**Shenim:** *Oferta e mësipërme për të gjitha kategoritë e permendura më sipër me normë interesi fikse "3.5% për 24 muajt e pare do të jetë vetem për një afat maturimi të kredisë prej 25 vjet.*<br><br>*Klientët të cilët do të zgjedhin afatin e kredisë 25 vjet dhe të cilët do të paguajnë rregullisht këstet e kredisë maximumi 30 ditë me vonesë në planin e pagesës së kredisë për 21 vitet e para të ripagimit të kredisë do të përfitojnë një normë interesi 0% për 4 vitet e fundit duke filluar në fillim të vitit të 22-të të ripagimit të kredisë.*<br><br>*Për më tepër nëse klientët do të jenë më shumë se 30 ditë me vonesë në çfarëdo pagesë të këstit të kredisë pas vitit te 21-të, norma e interesit të kontratës do të kthehet me kushte standarte dhe do të aplikohet në mënyrë të menjëhershme në këstin e rradhës pas vonesës së kryer.*<br><br>*Per klientet qe deshirojne norme fikse 3.5% per 24 muajt e pare por afat maturimi me te ulet se 25 vjet, formula e normes se interesit do te jete e ndryshme nga formulat e mesiperme ne varesi te afatit te kerkuar.*<br><br>**Monedha EURO**<br>**Për kolateral të njejtë me objektin e kredisë:**<br>Euribor 1 vjeçar + 3.75% *(e ndryshueshme çdo 12 muaj **jo më pak se 3.75%)***<br>***Ose***<br>*1.8% per 12 muajt e pare, me pas Euribor 1 vjecar + 4% (e ndryshueshme çdo 12 muaj **jo më pak se 4%)***<br>***Ose***<br>*3% per 24 muajt e pare, me pas Euribor 1 vjecar + 4%(e ndryshueshme çdo 12 muaj **jo më pak se 4%)*** |



*Ky dokument është pronë e BKT dhe nuk lejohet ndarja me palë të treta.*

| | |
|---|---|
| | *Ose*<br>*4.5% per 60 muajt e pare, me pas Euribor 1 vjecar + 3.75%(e ndryshueshme çdo 12 muaj **jo më pak se 3.75%)***<br><br>**Për kolateral të ndryshme nga objekti i kredisë:**<br>Euribor 1 vjeçar + 4% *(e ndryshueshme çdo 12 muaj **jo më pak se 4%)***<br>***Ose***<br>*1.8% per 12 muajt e pare, me pas Euribor 1 vjecar + 4.3%(e ndryshueshme çdo 12 muaj **jo më pak se 4.3%)***<br>***Ose***<br>*3% per 24 muajt e pare, me pas Euribor 1 vjecar + 4.3% (e ndryshueshme çdo 12 muaj **jo më pak se 4.3%)***<br>*Ose*<br>*4.5% per 60 muajt e pare, me pas Euribor 1 vjecar + 4% (e ndryshueshme çdo 12 muaj **jo më pak se 4%)***<br><br>**Kredia mund të akordohet në monedhen EURO vetëm për ato raste kur vlera e investimit do të jetë më e madhe ose e barabartë me **70,000 Euro**.*<br><br>**Për të gjitha produktet e përmendura më sipër klientët mund të zgjedhin ose jo sigurimin e jetës ose të pranojnë norme më të lartë interesi. Në rast se klienti zgjedh të mos bejë sigurimin e jetës, opsionet janë:*<br><br>- **Në qofte se klienti është deri në 45 vjeç, norma e interesit do të jetë 0.5 % më e lartë se norma e interesit e aplikuar për kategorinë përkatëse**<br><br>*Shembull për aplikimin e normës për Ofertën për Klientet Preferenciale. Norma e interesit do të ndryshoje nga:*<br><br>3.5 % për 24 muajt e pare, më pas Bono Thesari + 1.4%<br>***(jo me pak se 3.6% pas 24 muajve te para e ndryshueshme çdo 12 muaj)***<br>*Në:*<br>4% për 24 muajt e pare, më pas Bono Thesari + 1.9%<br>***(jo me pak se 4.1% pas 24 muajve te para e ndryshueshme çdo 12 muaj)***<br><br>- **Neqoftese klienti eshte mbi 45 vjeç, norma e interesit do te jete 1 % me e larte se norma e interesit e aplikuar per kategorine perkatese**<br><br>*Shembull per aplikimin e normes per Oferten per Klientet Preferenciale. Norma e interesit do te ndryshoje nga:*<br><br>3.5 % për 24 muajt e pare, më pas Bono Thesari + 1.4%<br>***(jo me pak se 3.6% pas 24 muajve te para e ndryshueshme çdo 12 muaj)***<br>*Ne:* |



*Ky dokument është pronë e BKT dhe nuk lejohet ndarja me palë të treta.*

| | |
|---|---|
| | 4.5 % për 24 muajt e pare, më pas Bono Thesari + 2.4***(jo me pak se 4.6% pas 24 muajve te para e ndryshueshme çdo 12 muaj)***<br><br>**Për të gjitha kategorite e përmendura më sipër dhe për kreditë në monedhën Euro do të veprohet në të njëjtën mënyrë.* |
| **5. Norma e interesit për Kredi për Dyqan**<br><br>**(tregon llojin e interesit dhe kohëzgjatjen e periudhës së përcaktuar, monedha Lekë/Euro)** | **Monedha LEKË**<br>Bono Thesari 1 vjeçare + 3% *(e ndryshueshme çdo 12 muaj)*<br>***(jo më pak se 5.3% pas 24 muajve te pare)***<br>**Monedha EURO**<br>**Për kolateral të njejtë me objektin e kredisë:**<br>Euribor 1 vjeçar + 4.6% ***(****e ndryshueshme çdo 12 muaj* ***jo më pak se 4.6%****)*<br><br>**Për kolateral të ndryshme nga objekti i kredisë:**<br>Euribor 1 vjeçar + 4.8% ***(****e ndryshueshme çdo 12 muaj* ***jo më pak se 4.8%****)*<br><br>**Kredia mund të akordohet në monedhën EURO vetëm për ato raste kur vlera e investimit do të jetë më e madhe ose e barabarte me* ***70,000 Euro****.*<br>**Klientët mund të zgjedhin ose jo sigurimin e jetës ose të pranojnë normë më të lartë interesi. Në rast se klienti zgjedh të mos bejë sigurimin e jetës, opsionet janë:*<br>- **Në qofte se klienti është deri në 45 vjeç, norma e interesit do të jetë 0.5 % më e lartë dhe do të jetë si më poshtë:**<br>Bono Thesari 1 vjeçare + 3.5% *(e ndryshueshme çdo 12 muaj)*<br>***(jo më pak se 5.8% pas 24 muajve te pare)***<br>- **Në qofte se klienti është mbi 45 vjeç, norma e interesit do të jetë 1 % më e lartë dhe do të jetë si më poshtë:**<br>Bono Thesari 1 vjeçare + 4% *(e ndryshueshme çdo 12 muaj)*<br>***(jo më pak se 6.3% pas 24 muajve te pare)***<br><br>**Për kreditë në monedhën Euro do të veprohet në të njëjtën mënyrë.* |
| **6. Norma efektive e interesit** | **Norma efektive e interesit (NEI)** shpreh totalin e kostos së kredisë duke përfshirë dhe interesat , komisionet dhe çdo lloj tjetër shpenzimi që kredimarrësi paguan në lidhje me kontratën e kredisë brenda kushteve të kësaj kontrate kredie. Për qëllime të llogaritjes së NEI totali i kostos së kredisë nuk përfshin shpenzime që nuk njihen në datën e llogaritjes së NEI, shpenzime të pagueshme nga kredimarrësi të detyrimeve për moszbatimin e kushteve të parashikuara në këtë kontratë, kostot e pagueshme nga klienti lidhur me marrëveshjen e kredisë për persona të tjerë (për shembull, një noter, autoriteti i taksave, regjistri i hipotekave) dhe çdo shpenzim në përgjithësi të detyruar për regjistrimin dhe garancitë; shpenzimet për siguracionin dhe/ose garancitë jo të detyrueshme, shpenzime per komisione të aplikuara për fondet e papërdorura dhe shpenzime komisionesh për ndryshim të kushteve kontraktore. NEI do të llogaritet me supozimin që :<br>- kontrata kredisë është e vlefshme për periudhen e rënë dakord, dhe<br>- palët plotësojnë detyrimet e tyre, sipas kushteve dhe datës së rënë dakord në këtë kontratë kredie, dhe |



*Ky dokument është pronë e BKT dhe nuk lejohet ndarja me palë të treta.*

| | |
|---|---|
| | - përqindja e interesit dhe shpenzimet e tjera që përfshihen në llogaritjen e NEI mbeten të pandryshuara (fikse) deri në fund te kontratës së kredisë. |
| **7. Vlera e kredisë dhe monedha në të cilën ofrohet** | **Shuma maksimale e kredisë** – 50,000,000 Lekë/ 400,000 EUR<br>**Monedha e kredisë** : Lekë/Euro |
| **8. Kohëzgjatja e kontratës së kredisë hipotekore** | **Afati Maksimal per Kredi per shtepi / Kredi per Ndertim Shtepie**<br>Deri në 25 vjet për Monedhen Lekë<br>Deri në 20 vjet për Monedhen Euro<br>**Afati maksimal per kredi per dyqan**<br>Deri në 25 vjet për Monedhen Lekë<br>Deri në 20 vjet për Monedhen Euro |
| **9. Çelja dhe Levrimi i Kredise** | - Si kusht për levrimin e kredisë, Kredimarrësi do të hapë një ose më shumë llogari rrjedhëse pranë Bankës Kombetare Tregtare, e quajtur "llogaria e kredisë", në të cilën Banka do të bëjë disbursimin e fondeve dhe nëpërmjet së cilës do të bëhet ripagimi kredisë.<br>- Terheqja e kredisë do të bëhet në një nga menyrat: më anë të tërheqjes në të<br>holla, me anë të tërheqjes me mjete elektronike, me anë të një ceku të lëshuar nga vetë klienti mbi bankën, me anë të urdhër-pagesës së dhënë me shkrim në favor të të tretëve.<br>- Kur gjatë disbursimit Banka konstaton se Kredimarrësi ka dale jashtë kushteve të parashikuara në Kontratën e Kredise nënshkruar nga palet, Banka ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kësaj kontrate që do të shoqërohet me kthimin e shumave të përdorura deri në atë moment dhe interesin përkatës. |
| **10. Numri dhe frekuenca e pagesave** | Shlyerja e kredisë do të kryhet me këste mujore të barabarta.<br>Numri i kësteve varion sipas afatit të maturimit. |
| **11. Vlera e çdo kësti për shlyerjen e kredisë hipotekore** | Kësti mujor = Shuma e kryegjësë + shumën e interesit |
| **12. Tabela e amortizimit të kredisë (plani i shlyerjeve)** | *Frekuenca e rishikimit të normës baze të interesit në këtë rast Bono Thesari është çdo 12 muaj, pra në çdo rast rishikimi i normës së interesit për çdo klient do të bëhet në këstin e 12 te vitit pasardhes deri ne fundin e afatit të maturimit të kredisë.* |



*Ky dokument është pronë e BKT dhe nuk lejohet ndarja me palë të treta.*

**Tabela e Llogaritjes së NEI (Normes efektive te interesit)**

## Termat e kredise dhe tabela per llogaritjen e NEI

| | | |
|---|---|---|
| Shuma e kredise | 4,000,000 | Leke |
| Afati i kredise (Nr. i kesteve) | 300 | Muaj |
| Mosha e Aplikantit | 27 | Vjec |
| Gjinia | Femer | |
| Tipi i klientit | Pagamarres ne BKT | |

| Norma e Interesit (=) | Bono Thesari 1 Vjecare | Plus (+) (Marzhi) |
|---|---|---|
| **3.45%** | **1.95%** | **1.50%** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Komisioni i Disbursimit | 1.0% | 40,000 | Leke |
| Primi i Sigurimit te Jetes | ~ 0.45%-0.65% e shumës së kredisë | 2,560 | Leke |
| Primi i Sigurimit te Prones | ~ 0.07%-0.15% e shumës së kredisë | 2,611 | Leke |
| Te tjera (nese ka) | | | Leke |
| Kesti Mujor | | 19,917.84 | Leke |
| **Norma Efektive e Interesit (NEI)** | | **3.56%** | |
| ***** | **5,975,352 Leke** | | |

** Shuma e totalit të kryegjësë dhe interesat për tu paguar është llogaritur me normën e mësipërme të interesit. Kjo shumë totale mund të ndryshojë në varësi të ndryshimeve të Bonos së Thesarit dhe minimumit të interesit të aplikuar sipas produktit të zgjedhur.*

## Tabela e amortizimit të kredisë (plani i shlyerjeve)

| Monedha | Shuma e Kredise | Norma e Interesit (ne %) | Afati i kredise ne vite | Afati i kredise ne muaj | Kesti Mujor i Kredise |
|---|---|---|---|---|---|
| Leke | 4,000,000 | 3.45% | 25 | 300 | 19,918 |
| **Muaji** | **Balanca Fillestare** | **Shuma e interesit** | **Ripagimi i principalit** | **Kesti Mujor i Kredise** | **Balanca Perfundimtare** |
| **1** | 4,000,000 | 11,500.00 | 8,417.84 | 19,918 | 3,991,582 |
| **2** | 3,991,582 | 11,475.80 | 8,442.04 | 19,918 | 3,983,140 |
| **3** | 3,983,140 | 11,451.53 | 8,466.31 | 19,918 | 3,974,674 |
| **4** | 3,974,674 | 11,427.19 | 8,490.65 | 19,918 | 3,966,183 |
| **5** | 3,966,183 | 11,402.78 | 8,515.06 | 19,918 | 3,957,668 |
| **6** | 3,957,668 | 11,378.30 | 8,539.54 | 19,918 | 3,949,129 |
| **7** | 3,949,129 | 11,353.74 | 8,564.10 | 19,918 | 3,940,564 |
| **8** | 3,940,564 | 11,329.12 | 8,588.72 | 19,918 | 3,931,976 |
| **9** | 3,931,976 | 11,304.43 | 8,613.41 | 19,918 | 3,923,362 |
| **10** | 3,923,362 | 11,279.67 | 8,638.17 | 19,918 | 3,914,724 |
| **11** | 3,914,724 | 11,254.83 | 8,663.01 | 19,918 | 3,906,061 |
| **12** | 3,906,061 | 11,229.93 | 8,687.91 | 19,918 | 3,897,373 |



*Ky dokument është pronë e BKT dhe nuk lejohet ndarja me palë të treta.*

<table>
<tr><td>13. Kosto shtesë të pakthyeshme në rastin kur aplikohen të tilla</td><td>- Shpenzime për raportin e vlerësimit të pasurisë (varion nga ~ ALL 7,500 – ALL 30,000 me TVSH në bazë të llojit të pasurisë objekt vlerësimi).<br>Kosto e përmendur më lartë klasifikohet si kosto para aprovimit dhe mbulohet nga aplikanti, pavarsisht vendimit përfundimtar. Kjo kosto është e pashmangshme nga aplikanti. Ky shërbim nuk ofrohet nga banka por nga ekspertë të autorizuar.</td></tr>
<tr><td>14. Kosto shtesë të tjera</td><td>
<table>
<tr><td>Lloji i shpenzimit</td><td>Vlera</td></tr>
<tr><td>Shpenzime noteriale dhe ligjore, si (noterizim kontratash)</td><td>Per kontraten e kredise ~ 3,000 Lekë<br>Per kontraten e hipotekes ne varesi te shumes se kredise, si me poshte:<br>Per shuma kredie nga 1-500,000 Lekë ~2,000 Lekë<br>Per shuma kredie nga 500,000- 1,500,000 Lekë ~ 3,000 Lekë<br>Per shuma kredie nga 1,500,000 – 5,000,000 Lekë ~4,000 Lekë<br>Per shuma kredie nga 5,000,000 – 15,000,000 Lekë ~6,000 Lekë<br>Per shuma kredie nga 15,000,000 – 50,000,000 Lekë ~8,000 Lekë<br>Per shuma kredie nga 50,000,000 – 100,000,000 Lekë ~10,000 Lekë<br>Per shuma kredie mbi 100,000,000 Lekë ~15,000Lekë</td></tr>
<tr><td>Primi i policës së sigurimit të jetës</td><td>~ 0.45%-0.65% e shumës së kredisë (Varion nga shum e kredisë, mosha dhe gjinia e aplikantit)</td></tr>
<tr><td>Shpenzimet e hipotekës</td><td>Per shuma kredie nga 1,000,001 Lekë deri ne 10,000,000 Lekë ~15,000 Lekë<br>Per shuma kredie mbi 10,000,000 Lekë ~25,000 Lekë</td></tr>
<tr><td>Primi i policës së sigurimit të kolateralit</td><td>~ 0.07%-0.15% e shumës së kredisë (Varion nga shum e kredisë, lloji i pronës dhe vendndodhja e saj, etj.)</td></tr>
<tr><td>Komision disbursimi</td><td>1% e shumës së kredisë<br>0% per blerje kredie nga banka te tjera (vetem ne rast kur kontrata e kredise qe do te blihet permban komisio ripagimi te parakohshem)</td></tr>
</table>
Kostot e mësipërme klasifikohen si kosto pas miratimit të kredisë. Këto shpenzime janë të pashmangshme dhe të detyrueshme para disbursimit të kredisë. Shpenzimet e hipotekimit, noterizimet e kontratave të kredisë dhe komisioni i angazhimit ekzekutohen vetëm një herë, ndërsa primet e policave të sigurimit të pronës dhe jetës përsëriten çdo vit.</td></tr>
<tr><td>15. Penaliteti per shlyerje para afatit të maturimit (kur është e aplikueshme)</td><td>- 2% të shumës së kredisë së paguar para afatit, nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë është mbi 1 vit<br>- 1 % të shumës së kredisë së paguar para afatit, nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë nuk kalon 1 vit</td></tr>
<tr><td>16. Njoftimi zyrtar midis paleve</td><td>Të gjithë njoftimet, komunikimet midis palëve do të bëhen me shkrim dhe me pëlqimin e dy paleve të dorëzuara personalisht ose me postë të regjistruar (rekomandë) në adresën e përcaktuar në Kontratën e Kredisë ose kur është e mundshme me një mjet të qëndrueshëm komunikimi (e-mail</td></tr>
</table>



*Ky dokument është pronë e BKT dhe nuk lejohet ndarja me palë të treta.*

| | |
|---|---|
| | përcaktuar në Kontratën e Kredisë, disketë, CD-ROM, DVD) .<br>Kredimarrësi/Dorëzanësi deklaron dhe pranon që të gjithë llojet e njoftimeve të bëra në këto adresa do të konsiderohen si të marra nga ai. Klienti mund t'i paraqesë Bankës reklamimet e tij, për sa njoftohet, brënda një afati prej 15 ditësh kalendarike.<br>Kredimarrësi/ Dorëzanësi është i detyruar që për çdo ndryshim në adresat e tij të njoftojë Bankën brënda 15 ditëve kalendarike për këto ndryshime. Për sa kohë që ai nuk ka njoftuar adresën e re, Kredimarrësi nuk ka të drejtë të kundërshtojë njoftimet e bëra në adresën e mëparshme. |
| **17. E drejta e tërheqjes nga kontrata e kredisë** | Klienti ka të drejtë të tërhiqet nga kontrata e Kredisë brenda një periudhe kalendarike 7 ditore. Ky afat fillon nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate. Në rastet kur shuma e kredisë është disbursuar në llogarinë e klientit dhe ky i fundit ushtron të drejtën për t'u tërhequr nga Kontrata e Kredisë, atëherë klienti pranon dhe merr përsipër të shlyejë kryegjënë dhe gjithë detyrimet për interesa dhe /ose penalitete, si dhe shpenzime të tjera të mundshme të bankës të krijuara me palë të treta për efekt të disbursimit të kësaj shume. |
| **18. Skemat e brendshme të ankimit** | - Paraqitja e kërkesës me shkrim pranë çdo dege.<br>- Vizitë pranë çdo dege.<br>- Nëpërmjet telefonit (+355 42 266 288) call center<br>- Nëpërmjet adreses elektronike info@bkt.com.al |
| **19. Penalitete të tjera** | - Në rast se Banka zbulon që kredia nuk është përdorur për qellimin e akorduar, atëherë ajo ka të drejtë që të kërkojë menjëherë rikthimin e kredisë dhe interesave të akumuluara, ose në rast se e gjykon të arsyeshme në vend të aplikimit të veprimit të sipër përmendur, mund të aplikojë 1% penalitet mbi shumën fillestare të kredisë.<br>- Në rast të mospagimit të komisioneve dhe interesit, Banka ka të drejtë të aplikojë një penalitet prej 4 (katër)% në Lekë dhe 3 (tre)% ne Euro, në muaj mbi shumën e papaguar të komisionit dhe interesit.<br>- Në rast se Kredimarrësi është në pamundësi për të ripaguar në kohë këstin e maturuar (interesin ose kryegjënë), Banka përvec normës së interesit normal, ka të drejtë të aplikojë penalitet në masën 4 (katër)% në Lekë dhe 3 (tre)% ne Euro në muaj, i llogaritur mbi detyrimin e këstit të rradhës së pa paguar (kryegjë + interes) për periudhën në të cilën ai është më vonesë në bazë të kushteve të kësaj kontrate. |
| **20. Periudha kohore e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor** | Periudha kohore e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor është 7 (shtate) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit te këtij informacioni nga klienti. |

_____________/____/____/_________
*(Qyteti, dd,mm,vvvv)*

Klienti: Emër Mbiemër
*(Firma)*

Punonjesi i Degës: Emër Mbiemër
*(Firma dhe Vula e Bankës)*



*Ky dokument është pronë e BKT dhe nuk lejohet ndarja me palë të treta.*